

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Prishtina vrapon në edicionin e 26-të të maratonës, gara deri në 42 kilometra e 195 metra
ADRESA	https://albeu.com/sport/prishtina-vrapon-ne-edicionin-e-26-te-te-maratones-gara-deri-ne-42-kilometra-e-195-metra/1019752/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 10:45:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 10:43:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	16dae70399a3ebc18b212c2b577c13b0166e9d78ac8034a0966dab273a7b7190
TEKSTI	9e1bdeddb58adc409f40ab6fcdbed7966cb69fa4fa9a7361b56cb3191602202e
PAMJA	f12a366208000d2ea33cb2b3abee94b46dc3bad9a4fae6b2f691356639398f1d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bf04053d7f5c06d3286f232129a7c48131682faab6605c04349f3046c95b6087
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1e4bbdcc86bb83ba0aea314f2faba748589132b4289d9e2a8edd562c2fbc5c80
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bf04053d7f5c06d3286f232129a7c48131682faab6605c04349f3046c95b6087>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Prishtina vrapon në edicionin e 26-të të maratonës, gara deri në 42 kilometra e 195 metra



Mbi 1 mijë e 700 vrapues morën pjesë në edicionin e 26-të të maratonës "Prishtina 2026", të organizuar nga Federata e Atletikës së Kosovës.

Kryetari i federatës, Halil Sylejmani, deklaroi për KosovaPress se pjesëmarrja nuk ishte vetëm shqiptare, pasi në garë kishte edhe atletë ndërkombëtarë.

Sipas tij, programi përfshinte disa disiplina: maratonën prej 42 kilometrash e 195 metrash, si dhe garat në 21, 10 dhe 5 kilometra. Për fëmijët ishte paraparë edhe distanca prej 2 kilometrash. Sylejmani u uroi sukses të gjithë pjesëmarrësve.

Gara nisi në orën 09:00 dhe ishte planifikuar të zgjaste 6 orë. Sylejmani tha se terreni ishte mjaft i mirë, por organizatorët po përballeshin me disa vështirësi nga komunikacioni, megjithëse aktiviteti ishte paralajmëruar te autoritetet dhe ishte kërkuar që për 5-6 orë të shmangeshin pengesat në trafik.

Ai shprehu besimin se qytetarët do të tregonin mirëkuptim dhe se aktiviteti, i cili kishte nisur mbarë, do të përfundonte po ashtu mirë. Sylejmani theksoi se synimi ishte përfaqësimi sa më i mirë i vetes dhe i shtetit, të cilin e përshkroi si të lirë për këdo që dëshiron të marrë pjesë.

Në mesin e garuesve, sipas tij, kishte pjesëmarrës nga Vojvodina apo Serbia, si dhe nga Kroacia, Sllovenia, Maqedonia dhe vende të tjera. Ai e cilësoi aktivitetin si një garë kombëtare me vlerë si për secilin atlet, ashtu edhe për vendin që përfaqëson.

Në maratonë u përfshinë të gjitha grupmoshat. Sylejmani bëri të ditur se ndër pjesëmarrësit më të moshuar ishte Muhamet Rama, shtetas nga Shqipëria, i cili është mbi 70 vjeç.

Pjesë e aktivitetit ishte edhe Artan Thaçi, djali i ish-humoristit të njohur Rasim Thaçi. Ai i tha KosovaPress se

të fundit /



Hysaj ende pa ekip, grumbullimi me Shqipërinë mund t'i...



U plagos në atentatin në Sarandë, 73-vjeçari transportohet me...



ADN-ja në Hagë identifikon Idriz Rrecajn pas 27 vjetësh, mbetj...



Sergio Aguero tregon arsyen pse Manchester City zgjodhi Enzo...



U ekzekutua sot në Sarandë, nëna e Artan Myrtajt shpërthen në...



OBRM-PDUKM akuzon LSDM-në për cenim të interesave kombëtare



Osmani: Modeli i Tirolit të Jugut ofron përvojë për fuqizimin e...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

kishte marrë pjesë disa herë në Maratonën e Prishtinës, por këtë edicion vrapimi i tij kishte një kushtim të veçantë.

I veshur me një fanellë që mbante stemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Thaçi tha se çdo ditë pas aktgjykimit dënues i dukej si ditë zie. Sipas tij, atmosfera dhe energjia e njerëzve nuk ishin aspak të mira, ndërsa vendimin e konsideroi të padrejtë dhe të ndikuar politikisht.

Thaçi u shpreh se populli vazhdon të shpresojë që ata të lirohen sa më shpejt dhe të kthehen në vendin e tyre. Ai theksoi se nuk mund të bëhet krahasim me agresorin dhe me njerëzit që kanë kryer gjenocid.

Abide Ujkani, e cila vrapoi 5 kilometra, tregoi se kjo ishte hera e tretë që merrte pjesë në maratonë. Ajo e vlerësoi organizimin si shumë të mirë dhe tha se nuk kishte hasur në asnjë vështirësi. Ujkani deklaroi gjithashtu se kishte vrapuar 10 kilometra dhe se, pasi pjesëmarrja ishte bërë e përvitshme për të, gjithçka kishte kaluar pa probleme.

Në garë morën pjesë edhe fëmijë. Sara Lekaj, 10 vjeçare, ishte për herë të parë pjesë e këtij edicioni dhe përshkoi 5 kilometra. Ajo tha se përvoja kishte qenë shumë e mirë, ndonëse në disa pjesë gara ishte bërë më e vështirë, por në fund e kishte realizuar synimin. Lekaj shprehu dëshirën që të merrte pjesë edhe në vitet e ardhshme.

Në përmbyllje u theksua rëndësia e pjesëmarrjes në maratona të tilla, ndërsa u bë thirrje që në edicionet e ardhshme numri i garuesve të rritet edhe më shumë.

Shtuar më 20.09.2026 12:43

Tags: Maratona prishtina 2026



Hysaj ende pa ekip, grumbullimi me Shqipërinë mund t'i hapë një kapitull ...



Sergio Aguero tregon arsyen pse Manchester City zgjodhi Enzo...



Gëzon Partizani, ish-kapiteni i të kuqeve rrezikon të mungojë për Egnatian



Mourinho përballë vendimit të vështirë: Vinicius Jr titullar apo në stol ndaj...



Balkani shpërthen pas disfatës ndaj Malishevës: Na vodhën titullin, nuk...



Erbilin Osmani zgjedh Kosovën, vendimi i talentit të Bayern Munichut merr...



VIDEO/ Dejvi Bregu protagonist në Arabinë Saudite, gol dhe asist në...



Sfida e 42 kilometrave: Kryeqyteti pushtohet nga entuziazmi i garuesve

albeu

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet


Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.